

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fituesja e çmimit “Oscar”, Susan Sarandon arrestohet në protestën pro-palestineze, ndërsa Netanyahu mbante fjalimin në OKB
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/fituesja-e-cmimit-oscar-susan-sarandon-arrestohet-n-e-protesten-pro-pal-i588268
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 08:29:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 08:26:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5dfabd1e14c29bf936db97429b15c48ac9a11de02e47c957a5879a13e745bf00
TEKSTI	2c0b3749adebde26c621b9448358280fc25c12408d43b65410a68edf1adf2fa
PAMJA	92cb12dab0c5c94a4db27440c3313f649b39b4afe2e4ffaac29d9be23a9bcdff

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c97f4d761af58770d4819c82a04f09fdcd8521555a76c6833eac41c84330a2ae
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdf651dfbc0b1533
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c97f4d761af58770d4819c82a04f09fdcd8521555a76c6833eac41c84330a2ae>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Fituesja e çmimit "Oscar", Susan Sarandon arrestohet ne protesten pro-palestineze, ndersa Netanyahu mbante fjalimin ne OKB](#)Grate me funde te gjata jane nena me te j fundit

Fituesja e çmimit “Oscar”, Susan Sarandon arrestohet në protestën pro-palestineze, ndërsa Netanyahu mbante fjalimin në OKB



25 Shtator 2026, 10:26Lifestyle TEMA



Aktorja fituese e çmimit “Oscar”, Susan Sarandon, u arrestua të enjten në Nju Jork gjatë një proteste pro-palestineze, e zhvilluar jashtë selisë së Kombeve të Bashkuara, në të njëjtën kohë kur kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu mbante fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme.

Sarandon ishte mes të paktën 30 personave të arrestuar nga policia e Nju Jorkut gjatë protestës kundër Netanyahu-t. Mes të ndaluarve ishte edhe aktorja Hannah Einbinder, e njohur për rolin e saj në serialin “Hacks”, si dhe disa figura politike amerikane.

Protesta u organizua nga “Jewish Voice for Peace”, një organizatë aktiviste hebraike që mbështet palestinezët. Rreth 200 persona u mbledhën pranë selisë së OKB-së, ku mbanin pankarta me mesazhe si “Stop armatosjes së Izraelit”, “Jo luftës” dhe “Palestinë e lirë”.

Sipas policisë së Nju Jorkut, protestuesit kishin bllokuar një kryqëzim dhe efektivët u kërkuar disa herë të largoheshin. Një pjesë e tyre u zhvendosën në trotuare, ndërsa grupi kryesor vijoi të qëndronte ulur në rrugë. Pas kësaj, policia ndërhyri dhe arrestoi personat që nuk iu bindën urdhrat për t'u larguar.

Pamjet nga protesta tregojnë Sarandon duke u marrë nga efektivët me duart e lidhura, ndërsa edhe Einbinder u shoqërua nga policia. Reuters raportoi se nuk ishte menjëherë e qartë nëse ndaj tyre do të ngriheshin akuza.

Arrestimi i Sarandon nuk është i pari rast kur aktorja merr pjesë në protesta lidhur me luftën në Gaza. Gjatë Festivalit të Filmit në Venecia këtë muaj, ajo deklaroi se kishte humbur mundësi pune për shkak të qëndrimeve të saj të shprehura publikisht.

Edhe Hannah Einbinder ka folur publikisht për çështjen palestineze dhe ka deklaruar më herët se nuk do të heshtë për këtë temë, edhe nëse kjo mund të ndikojë në karrierën e saj në Hollywood.

Protesta u zhvillua ndërsa Netanyahu përgatitej të fliste në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Gjatë fjalimit të tij, dhjetëra delegacione u larguan nga sallat në shenjë proteste.

Burimi: Reuters



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Angelina Jolie shet rezidencën historike në Los Angeles për 24.75 milionë dollarë](#)

09:39 Lifestyle

[12 vite pas aksidentit, gruaja e Michael Schumacher rrëfen dhimbjen: "Kur dëgjoj këngën tonë, qaj"](#)

09:00 Lifestyle / 1 koment

[“Nuk je më babai im”/ Francesco Totti zbulon momentin më të vështirë me vajzën pas ndarjes nga Ilary Blasi](#)

17:00 Lifestyle

[VIDEO/ Jennifer Lopez “pushton” pasarelat e Milanos](#)

16:15 Lifestyle

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.